



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 213/26 Dt. 12.05.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datës 15.10.2008, të nenit 10 dhe 19 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruara ndaj listës së përfituesve të bursave komunale, të publikuara nga Komisioni që ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave (aplikacioneve) dhe ndarjen e bursave për studentët, për vitin akademik 2025/2026. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Islam Osmankaj,
 - 1.2. Haxhere Gavazaj,
 - 1.3. Zani Vula,
 - 1.4. Nexhat Maçkaj, (anëtar rezervë).
2. Komisioni i përberë si në pikën 1 të këtij Vendimi, në mbledhjen e tij të parë do të zgjedhë kryesuesin e komisionit.
3. Komisioni, nga pika 1 e këtij Vendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me konkursin e shpallur për ndarjen e bursave dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
5. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe të emëruarit e këtij Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

